



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:205989

Datë: 09.09.2024

Numri i dokumentit: 06136405

**C.nr.3499/202**

**2**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtari Baki Shigjeqi, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.K.H. me numër personal .... nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Mamushës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e inflacionit në pagë, vlera e kontestit 545.23 euro, me datë 15 qershor 2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses E.K.H. nga Prizreni. **DETYROHET** e paditura Komuna e Mamushës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses t’ia kompensoj në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore 01 .10.2019 deri me 31.12.2019, në shumën prej 37.14 euro;
2. Për periudhën kohore 01 .01.2020 deri me 31.12.2020, në shumë prej 11.00 euro;
3. Për periudhën kohore 01 .01.2021 deri me 31.12.2021, në shumën prej 187.09 euro;
4. Për periudhën kohore 01 .01.2022 deri me 30.06.2030, në shumën prej 286.14 euro.

**Në shumën e përgjithshme prej 521.37 euro,** me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 07.10.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**II. REFUZHET** e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 545.23 euro, përkatësisht shuma prej **23.86 euro,** në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

**III. DETYROHET** e paditura, që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **124.00 € (njëqind e njëzetë e katër) euro**, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### A r s y e t i m

Paditësja E.K.H. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj av. A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datë 07.10.2022, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mamushës–Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa përmes parashtrësës së datës 15.11.2022. ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar nga gjykata që ta detyroi të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 01.08.2019 e deri me datën 30.06.2022 në shumën prej 545.23 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Në referatin e padisë ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në institucionin arsimor “ATATURK” në Mamushë, nuk ka pranuar mjete e parapara për kompensimin e shpenzimeve të inflacioni në pagë, dhe bazuar në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

E paditura Komuna e Mamushës – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes drejtorit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi më datë 21.12.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësja ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësja nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditëses se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Mamushës është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadija e paditëses është e pa bazuar. Në fund ka theksuar bazuar në dispozitat të nenit 353 të LMD-së, të drejtat të cilat rrjedhin nga kontrata kolektive e vitit 2017 janë parashkruar, andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399

të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 002/16, e datës 01.09.2016, dhe vërtetimi me nr.576/22 i datës 28.04.2022, për paditësen e lëshuar nga Komuna e Mamushës–Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja ka krijuar marrëdhënie pune me të paditurën, në shkollën e mesme të lartë “ATATURK” në Mamushë, si mësimdhënëse e matematikës. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet pagës bazë e paditëses e që është shuma prej 459.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. ***Gjykata përlllogaritjen e kompensimit mbi bazën e inflacionit e ka llogaritur sipas pagës së kërkuar nga paditësja në shumën prej 458.56 euro dhe jo sipas pagës bazë të cilën e merr paditësja në shumën prej 459.00 bazuar në listën e pagave, kjo në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së, ku thuhet “Në procedurën kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, andaj edhe përlllogaritja është bërë në këtë mënyrë:***

- Për periudhën 01 Tetor - Dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga e paditëses si pas kërkesës ka qenë 458.56 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën është 37.14 euro ( $458.56 \times 2.7\% = 12.38 \times 3 \text{ muaj} = 37.14 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën 01 Janar - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga e paditëses si pas kërkesës ka qenë 458.56 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 11.00 euro ( $458.56 \times 0.2\% = 0.91 \times 12 \text{ muaj} = 11.00 \text{ euro}$ ).

- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga e paditëses si pas kërkesës ka qenë 458.56 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 187.09 euro ( $458.56 \times 3.4\% = 15.59$  euro x 12 muaj = 187.09 euro).
- Për periudhën 01.01.2022 deri me 30.06.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, mirëpo në kërkesën e paditëses është kërkuar në shkallë të inflacionit prej 10.4%, në këtë drejtim gjykata në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së, “vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, ashtu që duke pasur parasysh se paga e paditëses si pas kërkesës ka qenë 458.56 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 286.14 euro ( $458.56 \times 10.4\% = 47.69$  euro x 6 muaj = 286.14 euro).
- Në shumën e përgjithshme prej 521.37 euro ( $37.14 + 11.00 + 187.09 + 286.14 = 521.37$ ).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të Ligjit të Punës shprehimisht theksohet që “*të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”. Në këtë drejtim, paditësja padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 07.10.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.08.2019 deri më datën 30.09.2019.

Me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 07.10.2022 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.10.2019 e deri më 30.06.2022, edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më dt. 07.10.2022 gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin tetor 2019, pasi që parashkrimi për kërkesën e paditëses për këtë muaj 2019 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që e njëjta ka pranuar pagën e këtij muaji, e cila i realizohet në fund të muajit, rrjedhimisht e njëjta pas pranimit të kësaj page është njoftuar se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin tetor 2019 dhe nga fillimi i muajit vijues saktësisht nëntor 2019, e njëjta ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, me të cilin parashihet që “*Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër*”.

Gjithashtu gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke ia njohur paditëses kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit, jo sipas pagës bazë që e realizon paditësja në shumën prej 459.00 euro, por sipas shumës së pagës të cilën e ka kërkuar paditësja dhe atë në shumën prej 458.56.00 euro. Andaj, bazuar në nenin 2 par. 2.1 të LPK-së, parashihet “*Në procedurën kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga*

palët ndërgjyqëse”, pra mbi këtë bazë gjykata vendosi brenda kërkesës së palës paditëse, më gjerësisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke marrë për bazë pagën bazë 458.56 sipas kërkesës së palës e jo sipas listës së pagës. Po ashtu gjykata, refuzoi të pabazuar kërkesën e paditëses sikurse në pikën nën II, të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë sa i përket parashkrimit të kërkesës për 2 muaj (nga data 01.08.2019 deri me datën 30.09.2019), e në shumën e tërësishme prej **23.86 euro**.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (07.10.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, përkatësisht për precizimin e padisë meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143, 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
2022:205989, 09.09.2024

**G j y q t a r i**

---

**Baki Shigjeqi**

Numri i lëndës: 2022:205989  
Datë: 09.09.2024  
Numri i dokumentit: 06136405

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.